

Pyetje të shpeshta (FAQ)

Për çfarë shërben pyetësi?

- Bëhet fjalë për një pyetësor mbi aftësitë e gjuhës gjermane të fëmijëve me gjermanishten si gjuhë të dytë. Pyetësi plotësohet nga prindërit. Fëmijët tuaj mund të jenë midis 33 dhe 48 muajsh.
- Pyetësi tregon nivelin e njohurive të gjuhës gjermane. Nëse niveli është i ulët, lind nevoja për ndihmë mësimore.
- Pyetësi ndihmon në përmirësimin e mundësive arsimore të fëmijëve që rriten duke folur shumë gjuhë ose të fëmijëve me prejardhje migracioni.

Për çfarë bën fjalë pyetësi DaZ-E?

- Pyetësi DaZ-E është hartuar mbi bazën e rregullave shkencore. Ai shërben si tregues i aftësive gjuhësore. Është i disponueshëm në formë letre në dymbëdhjetë gjuhë dhe në formë faqe interneti në njëmbëdhjetë gjuhë.
- Prindërit u përgjigjen pyetjeve në lidhje me përdorimet gjuhësore të fëmijëve të tyre.

Kush e ka hartuar pyetësin?

- Pyetësi është hartuar në Fakultetin e Psikologjisë të Universitetit të Bazelit. Përgjegjës është departamenti i psikologjisë së zhvillimit dhe personalitetit.

Kush e ka porositur?


- Porosia për kryerjen e këtij studimi është bërë nga bashkia ose kantoni. Logoja përkatëse ndodhet tek pyetësi.

Cila është fusha e këtij projekti?

- Në vitin 2008, kantoni i qytetit të Bazelit nisi programin "Në kopsht me njohuri të mjaftueshme të gjermanishtes". Ai synon të ekuilibrojë mundësitë arsimore të fëmijëve me dhe pa gjermanishten si gjuhë familjare.
- Që nga viti 2013, në kantonin e qytetit të Bazelit ekziston një "detyrim selektiv". Nëse 1 vit e ½ para se fëmijët të fillojnë kopshtin vihet re se njohuritë e tyre të gjuhës gjermane janë të pamjaftueshme, fëmijët duhet të ndjekin një institucion që ofron mundësinë e mësimin të integruar të gjuhës gjermane. Mësimi i gjuhës gjermane zhvillohet dy gjysmë ditë në javë për një vit.
- Bashki dhe kantonet të tjera i janë bashkuar këtij modeli. Shtrirja e mbështetje dhe angazhimit mund të ndryshojë nga modeli i Bazelit.

Si vlerësohet cilësia e pyetësit?

- Pyetësi plotëson dhe tejkalon standardet e kritereve të cilësisë statistikore të testit.
- Që nga momenti i ratifikimit dhe standardizimit, pyetësi është kontrolluar vazhdimisht dhe është zhvilluar më tej.



Cfarë ndodh me të dhënat e mia?

- Bashkia ose kantoni cakton një kod numerik për secilën familje. Në këtë mënyrë kriptohen informacionet personale të familjes. Vetëm bashkia përkatëse e kantonit mund t'u caktojë familjeve kodet numerike.
- Universiteti i Bazelit merr vetëm kodet numerike nga bashkitë.
- Ndarja e kodit numerik nga informacioni personal garanton anonimitetin e të dhënave.
- Universiteti i Bazelit i përdor të dhënat anonime për zhvillimin e mëtejshëm të pyetësorit dhe për qëllime kërkimore.
- Bashkia përkatëse e kantonit mund të marrë një vendim mbështetje bazuar në nivelin e aftësive gjuhësore.